

## Kalendari Ngritja e kampionëve Dhjetor 2018

1. Krishtlindja është një kohë dhurimi dhuratash , por burrat dhe baballarët shpesh ndiejnë presion për të shpenzuar shumë para për dhurata. Lutuni që këta burra do të njohin dhe demonstrojnë parimin e ruajtjes së thesareve në qiell. (Mateu 6: 19-20)

2. " Sepse sot në qytetin e Davidit lindi për ju një Shpëtimtar, që është Krishti, Zoti." Lutuni që etërit do t'u mësojnë fëmijëve të tyre për Shpëtimtarin, Jezusin, ndërsa ata festojnë këtë stinë të lindjes së Tij. (Luka 2:11)

3. Sezoni i Krishtlindjes mund të jetë plot tension dhe stresues. Lutuni që burrat dhe baballarët t'i afrohen Krishtit dhe të reflektojnë paqen e Tij ndaj familjeve të tyre, veçanërisht gjatë të mbledhurit bashkë si familje. (Isaia 9: 6)

4. Edhe pse një kohë gëzimi, për disa festa e Krishtlindjes mund të jetë gjithashtu një kohë pikëllimi, zhgënjimi dhe mërzi. Zemërimi dhe fjalët e hidhura mund të jenë prezent në atë ditë. Lutuni që etërit do të kërkojnë Zotin dhe me këto emocione dhe do shkojnë para Perëndisë dhe të mos lejojnë që zemërimi i tyre të ndizet. (Jakobi 1:20)

5. Pasi pa Jezusin, «barinjët u kthyen, duke përlëvduar dhe lavdëruar Perëndinë për të gjitha gjërat që kishin dëgjuar dhe parë, ashtu si u ishte thënë atyre.» Lutuni që etërit do të modelojnë udhëheqjen hyjnore për fëmijët e tyre, që në këtë mënyrë dhe ata të mund ta lavdërojnë Perëndinë për çfarë dëgjuan dhe panë . (Luka 2:20)

6. Ki mëshirë për ne, o Perëndi, sipas dashurisë sate të pandërprerë; sipas mëshirës sate të madhe, fshij shkeljet tona. Largoje gjithë

paudhësinë tonë dhe na pastro nga mëkati ynë. (Psalmi 51: 1-2)

7. Sepse ne pranojmë shkeljet tona dhe mëkati ynë na rri gjithnjë përpara. Kundër teje vetëm kundër teje, kemi mëkatuar dhe kemi bërë atë që është e keqe në sytë e tu; me qëllim që ti të njihesh i drejtë kur flet dhe i ndershëm kur gjykon. (Psalmi 51: 3-4)

8. Krijë në zemra të pastra, o Perëndi, dhe përtëri tek ne një frymë të patundur. Mos na largo nga prania jote dhe mos na hiq Frymën tënde të Shenjtë. Kthena gëzimin e shpëtimit dhe na përkrah me frymë dashamirëse (Psalmi 51: 10-12)

9. Atëherë ne do t'u mësojmë rrugët e tua shkelësve dhe mëkatarët do të kthehen drejt teje. (Psalmi 51:13)

10. Hapi buzët tona, o Zot, dhe goja jonë do të shpallë lëvdimin tënd. (Ps 51:15)

11. Ti në fakt nuk ndjen ndonjë kënaqësi në flijim, përndryshe ne do ta ofronim, nuk të pëlqen as olokausti. Flijimet tona o Perëndi janë frymë e thyer; ti nuk e përçmon zemrën e thyer dhe të penduar. (Ps 51: 16-17)

12. Kur ndodh një situatë krize (e veshtirë), mos lejo të ta dobësojë besimin; përkundrazi, ki besim te Zoti për të forcuar zemrën tënde. "Prandaj tani," thotë Zoti, "kthehuni tek unë me gjithë zemrën tuaj, me agjërime, me lot dhe me vajtime". Prandaj grisni zemrën tuaj dhe jo rrobat tuaja dhe kthehuni tek Zoti, Perëndia juaj, sepse ai është i mëshirshëm dhe plot dhemshuri, i ngadalshëm në zemërim dhe me shumë dashamirësi. "(Joeli 2: 12, 13).

13. Kur zhgënimet na dekurajojnë, lutja është një mundësi për t'u rifokusuar dhe për të kujtuar se si Perëndia ka qenë besnik gjatë viteve. "Dhe unë

thashë: 'Shkaku i hidhërimit tim është se dora e djathtë e Shumë të Lartit ka ndryshuar".Do t'i kujtoj veprat e Zotit; po, do të kujtoj mrekullitë e tua të kohëve të kaluara"(Ps 77: 6,10-, 11).

14. Kampionët frymorë duhet të vazhdojnë të pihen në besimin e tyre, dhe në të njëjtën kohë të mësojnë nga sinqeriteti i butë i fëmijëve. "Dhe Jezusi, pasi thirri një fëmijë të vogël pranë vetes, e vuri në mes tyre dhe tha: "Në të vërtetë po ju them: në qoftë se nuk ktheheni dhe nuk bëheni si fëmijët e vegjël, ju nuk do të hyni fare në mbretërinë e qiejve. Kush, pra, do të përulet si ky fëmijë i vogël, do të jetë më i madhi në mbretërinë e qiejve» (Mateu 18: 2 -4). Ne lutemi që të lëmë mënjane mënyrat feminare duke ruajtur një zemër feminare për të mësuar.

15. Megjithëse ne përballemi me kundërshtimin nga bota, mishi dhe djalli, lutemi të bëjmë tonën fitoren që Krishti ka fituar për ne."Dhe Perëndia i çdo hiri, që ju thirri në lavdinë e tij të përjetshme në Krishtin Jezus, mbasi të keni vuajtur për pak kohë, do t'ju bëjë të përsosur ai vetë, do t'ju bëjë të patundur, do t'ju forcojë dhe do t'ju vërë themel. "(1 Pjetrit 5:10).

16. Lutemi që të jemi shembuj jete të përqendruar te Krishti për fëmijët tanë dhe të rinjtë e tjerë që na shohin. "Bijtë e bijve janë kurora e pleqve, dhe lavdia e bijve janë etërit e tyre." (Prov 17: 6).

17. Atë Perëndi, kur ndodhin gjëra të këqija unë trembem. Shoh se përjetoj frikë kur i besoj burimeve të mia të kufizuara njerëzore. Por tani unë të besoj Ty, Perëndisë së Plotfuqishëm, burimet e të cilit janë të pakufishme. Besimi im nuk është më i vogël, por i madh, sepse tani po i besoj Perëndisë së madh dhe të fuqishëm. Faleminderit, Zot, që më ke dhënë besim të madh! (Mateu 8:26)

18. I dashur Zot, ka raste kur ndihem kaq i frikësuar. Shoh se frika mund të jetë një gjë e mirë. Frika më kujton se mishi im është i dobët, por Zoti është forca e jetës sime. Prandaj, kur kam frikë, do të kem besim te Zoti. Dhe ndërsa unë kam besim te ti, o Zot, nuk do të kem frikë nga asnjë e keqe! (Psalmi 56: 3-4)

19. Zot Jezus, nganjëherë kur nuk marr atë që unë mendoj se kam nevojë, ose nuk mund të kuptoj diçka, shqetësohem dhe mërzitem. Por ti ke folur qartë me Martën se Ti je gjithçka kemi nevojë! Dhe unë të kam ty , sepse ti jeton brenda meje. Më e rëndësishmja, është qe Ti më ke mua dhe Ti kurrë nuk do të më braktisësh kurrë. Prandaj, Ti do të japësh gjithçka që kam nevojë. (Luka 10: 41-42)

20. O Zot, më mërzisin kaq shumë gjëra dhe pastaj shqetësohem. Por Ti me ke dhënë mua një alternativë të sukseshme. Ti më fton të lutem TY. Tani nuk jam më nën presionin e të kujdesurit për çdo gjë, sepse e di që do të kujdesesh për gjithçka. Paqja jote brenda meje ruan zemrën dhe mendjen time nga shqetësimi. (Fil. 4: 6-7)

21. Forcat e liga vazhdimisht çdo herë bëjnë çmos për t'i privuar besimtarët si ty nga një marrëdhënie e ngushtë me Jezusin. Si ndjekës të Krishtit, ne duhet gjithnjë të inkurajojmë njëri-tjetrin që të qëndrojmë të patundur në besimin tonë. (1 Korintasve 16:13)

22. Arsyeja kryesore që shumë të krishterë dështojnë në mënyra të ndryshme, duke rënë në zakone të ndryshme mëkatore, është se ata nuk duan të kalojnë kohë me Zotin. Lutuni që Perëndia do t'ju lejojë të rriteni në shenjtëri duke investuar kohën e përditshme në një shoqëri personale dhe intime me Atë. (1 Kronikave 16: 8-11)

23. Si ndjekës të Krishtit, ne po luftojmë brenda nesh një betejë shpirtërore që vazhdon çdo ditë. Por lavdi Perëndisë - që duke u kapur tek Zoti dhe Shpëtimtari ynë, ne mund ta fitojmë atë betejë. (Ps 84: 5)

24. Shumë njerëz përpiqen të gjejnë një kuptim në jetën e tyre. Disa rrëfejnë hapur se ata besojnë se jeta e tyre nuk ka asnjë qëllim. Lavdi Perëndinë që, si një ndjekës i Krishtit, ti ke lajm të mirë për ta. (Zbulesa 22:17)

25. Lutuni sot për mençuri dhe forcë për të ndarë lajmin e mirë me dikë që po përpiqet të gjejë përgjigje në pyetje si këto: Pse jam këtu? Cili është qëllimi i jetës dhe i sfidave me të cilat po përballem? (Marku 16:15)

26. Falënderoni Zotin për përgjigjen shumë pozitive ndaj studimit të Biblës "Çdo burrë është një luftëtar" që TWR promovon në mbarë botën. Perëndia po i pajis burrat ndërsa ecin me Të dhe e lejojnë Fjalën e Perëndisë të ripërtërijë mendjet dhe qëndrimet e tyre. Shumë gra e lavdërojnë Perëndinë për burrat që kanë një pikëpamje të re për jetën dhe një përkushtim të vendosur për t'i udhëhequr familjet e tyre në rrugën e Zotit. (Titit 1: 6-9)

27. Ngritja e Kampionëve (CA), shërbesa e TWR për burrat nëpërmjet lutjes dhe programeve, ka nisur dy episode të reja, "Çdo burrë është një luftëtar i dliër" dhe "Jeta e shkëmbyer". Lutuni për procesin e përkthimit dhe të prodhimit të këtyre programeve në 15 gjuhët, në të cilat NK tashmë i shërben, në këtë kohë.

28. Konfliktet shoqërore, fatkeqësitë natyrore, ideologjitë ateiste, luftërat dhe ato çfarë sjell lufta, janë karakteristike e botës së sotme. Në dritën e kohëve të fundit, Bibla na thërret që të jetojmë jetë të shenjta dhe të perëndishme dhe të presim me

padurim ditën e Perëndisë dhe të shpejtojmë ardhjen e Tij (2 Pjetrit 3: 11, -12). Prandaj, mos konsumoni zemrën dhe mendjen tuaj me ngjarjet që ne nuk mund të ndryshojmë; përkundrazi, lejoni që paqja e Perëndisë të kontrollojë zemrën dhe mendjen tuaj.

29. Ekziston një krizë e udhëheqjes mashkullore në kishë. Lutuni që burrat e krishterë nuk do të shqetësohen së pari se çfarë duhet të hanë, dhe çfarë të pijnë, apo çfarë të veshin. Përkundrazi, ata duhet t'i besojnë Atit të tyre qiellor, i cili e di se çfarë kanë nevojë dhe ndjekin paralajmërimin e Zotit: "Por para së gjithash kërkoni mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e tij dhe të gjitha këto gjëra do t'ju shtohen." (Mateu 6:33 ).

30. Ndëkohë që vitit po i vjen fundi, merrni kohë për të kujtuar drejtimin dhe mirësinë e Zotit gjatë 12 muajve të fundit. Bëni një listë të të gjitha gjërave që Ai bëri me ju dhe me familjen tuaj dhe planifikoni të festoni ate çfarë Perëndia siguroi me një qëllim të caktuar . "Beko, shpirti im, Zotin, dhe të gjitha ato që janë tek unë të bekojnë emrin e tij të shenjtë."(Ps 103: 1).

31."Gjej kënaqësinë tënde në Zotin dhe ai do të plotësojë dëshirat e zemrës sate. Vendose fatin tënd tek Zoti, ki besim tek ai dhe ai ka për të vepruar. Ai do të bëjë të shkëlqejë drejtësia jote si drita dhe ndershmëria e saj si mesdita."(Ps 37: 4-6).